REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 821/20
Datë/Datum. 13.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.821/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Z. Blerim Dina - Kryetar, Z. Nuhi Paçarizi -Referues, Z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "EX PROJEKT" SH.P.K –Ferizaj, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me eksploziv LOT-1", me numër të prokurimit: 12997 12998-20-4146-1-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – "TREPÇA" SH.A, më datën: 12.11.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik "EX PROJEKT" SH.P.K –Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me eksploziv LOT-1", me numër të prokurimit: 12997 12998-20-4146-1-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – "TREPÇA" SH.A.

II. **VËRTETOHET**, njoftimi për anulimin e aktiviteti të prokurimit me titull "Furnizim me eksploziv LOT-1", me numër të prokurimit: 12997 12998-20-4146-1-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – "TREPÇA" SH.A.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "EX PROJEKT" SH.P.K –Ferizaj, aprovohet pjesërisht si e bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues "EX PROJEKT" SH.P.K –Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 19.10.2020 me nr. 821/20, kundër njoftimit për Anulim për e aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me eksploziv LOT-1", me numër të prokurimit: 12997 12998-20-4146-1-1-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – "TREPQA" SH.A., duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 9, 38, 56.3, 59, 62, si dhe nenin108A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 8.44 dhe 56 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.10.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues/Teknik të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues/Teknik i prokurimit në raportin e dt: 28.10.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:
Përgjigje në Pretendimi Nr. 1
Pretendim kryesore ka te beje me anulimin e aktiviteti te prokurimit "Furnizim me eksploziv" (për Minieren e Stantërgut) LOT 1 pasi dy ofertat e pranuara tejkalojnë çmimin e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit". **Eksperti shqyrtues/ teknik** sqaron se autoriteti kontraktues e ka pezulluar ketë aktivitet te prokurim pasi ofertat e pranuara tejkalojnë çmimin e planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit, pasi qe vlera e mjeteve te alokuara për ketë aktivitet ka qene për LOT 1 : **390.000,00€**, ndërsa oferta e operatorit ekonomik ankues për LOT1 është **537,195.00€**Në bazë të LPP-së të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në mase substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit, duhet të anulohet ky aktivitet Andaj, pretendimi i operatorit ekonomik ankues është i pa bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartë përmendura, eksperti shqyrtues/ teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE "Ex-Project" shpk -Ferizaj, te aprovohet si e pa bazuar, si dhe rekomandojnë që të mbete ne fuqi vendimi i AK-se njoftimi për anulim të këtij aktiviteti.

Organi Shqyrtues i Prokurimit me datën 28.10.2020 ka njoftuar palët me raportin e ekspertizës.

Autoriteti Kontraktues me datë 28.10.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë 01.11.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në, se me date 28.10.2020, përmes e-mailit zyrtar nga OSHP kemi pranuar raportin e ekspertit shqyrtues për tenderin: "Furnizim me eksploziv (LOT 1)",numri i aktivitetit të prokurimit: 12997 12998-20-4146-1-1-1. Dhe konform nenit 115.1 të LPP ju njoftojmë se me këtë raport nuk pajtohemi, sepse nga ana e ekspertit shqyrtues nuk është sqaruar drejt i gjithë procesi i zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit Panelin Shqyrtues e njoftoj me kundërshtimet tona lidhur me këtë ekspertize dhe atë si më poshtë: -ekspertiza e ekspertit shqyrtues – teknikisht është e mangët në aspektin e trajtimit të pretendimeve ankimore ,pa shqyrtim te evaluimit të këtij tenderi dhe si ka ardhur deri te tejkalimi i buxhetit nga ofertat e OE pjesëmarrëse në këtë aktivitet të prokurimit, -Në cilën faze të aktivitetit të prokurimit ka ndodhur ndryshimi i sasive dhe me vërejtjen e kujt, -Përgjegjësi e kujt është sigurimi i fondeve ,pas ndryshimit të sasive gjatë fazës tenderuese sepse është e kuptueshme edhe e logjikshme se duhet të rritet edhe vlera e parashikueshme për kontratë me rastin e shtimit të sasive. -AK-para dorëzimit të ofertave ka qenë i detyruar të njoftoj OE të cilët kanë tërheq DT se nuk ka buxhet shtesë ose të njoftoj se anulohet aktiviteti i prokurimit në mungese të sigurimit të fondeve shtesë dhe jo pas dorëzimit të ofertave sepse kjo mund të merret apo të kuptohet ta shikojmë se kush po del me i liri e pastaj te veprojmë, ta shpërblejmë me kontrate ose ta anulojmë!!. -Ne kemi dyshime se AK me qëllim e ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit vetëm e vetëm se ne kemi qenë të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 12.11.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit teknik të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "EX PROJEKT" SH.P.K –Ferizaj, që ka të bëjë kundër anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, pasi dy ofertat e pranuara tejkalojnë çmimin e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit". Paneli Shqyrtues conform eksperti shqyrtues/ teknik sqaron se autoriteti kontraktues e ka

pezulluar ketë aktivitet të prokurimit pasi ofertat e pranuara tejkalojnë çmimin e planifikuar për këtë aktivitet të prokurimit, ku vlera e mjeteve të alokuara për këtë aktivitet ka qenë për LOT 1 : 390.000,00€, ndërsa oferta e operatorit ekonomik ankues për LOT1 është 537,195.00€. Në bazë të LPP-së, të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime të cilat në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit dhe duhet të anulohet ky aktivitet i prokurimit.

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit të pretendimit ankimor dhe sqarimeve të ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në harmoni me nenin 62 të LPP-së pasi që tenderët e operatorëve ekonomik kanë tejkaluar vlerën e parashikuar të kontratës në masë të madhe.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Blerim Dina

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "TREPQA" SH.A.;

1x1 OE "EX PROJEKT" SH.P.K –Ferizaj;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.